



BP PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR

PROPOZIM

Në bazë të nenit 47, paragrafit (1), pikës 4) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21 dhe 74/24) dhe nenit 103, paragrafit (1), pikës 1) të Ligjit për Bankat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16 dhe 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19 dhe 122/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

VENDIM

**për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për
planin kontabël për bankat**

1. Në Vendimin për planin kontabël për bankat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 81/11, 152/11, 110/13, 141/16, 83/17, 96/17, 152/17 dhe 142/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 250/20), në pikën 8 fjalët: "Republika e Maqedonisë", zëvendësohen me fjalët: "Republika e Maqedonisë së Veriut", ndërsa fjalët "Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë", zëvendësohen me fjalët: "Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut".

2. Në Shtojcën 1 nga Vendimi për planin kontabël për bankat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 81/11, 152/11, 110/13, 141/16, 83/17, 96/17, 152/17 dhe 142/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 250/20), përshkrimi i llogarisë 0043 ndryshohet dhe bëhet:

"Mjetet me të drejtë përdorimi (mjetet e marra me qira)".

3. Përshkrimi i llogarisë 048 ndryshohet dhe bëhet:

"Anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në Fondin Monetar Ndërkombëtarë".

4. Përshkrimi i llogarisë 0480 ndryshohet dhe bëhet:

"Anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në Fondin Monetar Ndërkombëtarë-kuota".

5. Përshkrimi i llogarisë 2954 ndryshohet dhe bëhet:

"Detyrime në valutë të huaj për pagesa të përkohshme nga persona të vendit dhe të huaj për themelimin e shoqërive tregtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut".

6. Përshkrimi i llogarisë 3003 ndryshohet dhe bëhet:

“Valuta jasht vendit - të blera jasht vendit, por nuk janë sjellur në Republikën e Maqedonisë së Veriut”.

7. Përshkrimi i llogarisë 78 ndryshohet dhe bëhet:

“Detyrime për qira në valutë të huaj”.

8. Pas llogarisë 78556 shtohen llogaritë:

“787 Amvisëritë
7871 Deri një vit
7873 Prej një deri në dy vite
7874 Mbi dy vite
7876 Të maturuara”.

9. Përshkrimi i llogarisë 88 ndryshohet dhe bëhet:

“Detyrime për qira në denarë”.

10. Pas llogarisë 88556 shtohen llogaritë:

“887 Amvisëritë
8871 Deri një vit
8873 Prej një deri në dy vite
8874 Mbi dy vite
8876 Të maturuara”.

11. Përshkrimi i llogarisë 889 ndryshohet dhe bëhet:

“Detyrime për qira në denarë me klauzolë valutore”.

12. Pas llogarisë 889556 shtohen llogaritë:

“8897 Amvisëritë
88971 Deri një vit
88973 Prej një deri në dy vite
88974 Mbi dy vite
88976 Të maturuara”.

13. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë të publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2025.

V. nr. 02 – 43728/8
26 dhjetor 2024
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска